



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Nr. 1019 prot.

Gjirokastrë, më 24.06. 2024

Aprovoi

REKTOR

Prof. dr. Bektash MEMA



Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin INTERCON, Spanjë

Në kuadër të Programit Erasmus+, INTERCON hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me **3 pozicione** për studentë për mësimnxënie për një periudhë tre-mujore. Thirrja është e hapur për studentët e ciklit të parë të studimit (Bachelor) në Fakultetin Ekonomik, dhe në programin e studimit "Teknologji Informacioni", viti II ose III. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht B2 ose spanjisht B2.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **05.07.2024**, në formë fizike dhe elektronike:

- vërtetim student;
- Letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në anglisht;
- provë / çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose spanjolle në nivelin B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor do t'i përcjellë nominimet te INTERCON për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Shënim: Aplikantët do të paraqiten për intervistë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për të provuar njohuritë e tyre të gjuhës angleze.

Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Irma Gjolleshi